



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

### E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.07.2022,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Bahri Gashi dhe Shegë Beqiri.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Arben Kçira, udhëheqës i Zyrës ligjore dhe Osman Bllaca.

Para së të fillonin më diskutimet për pikat e rëndit të ditës, **Valbona Makolli - Ahmeti** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022". Arsyja për hyrjen në rend dite është se deri tani Ministria e Financave nuk e ka bërë aprovimin e bartjes së mjeteve prej vitit 2021 në vitin 2022 dhe pas 2 muajve kërkesa të vazhdueshme dhe direkt me kryetarin dhe nënkyetarin dhe Ministrinë e Financave, ka ardhur në përfundim që 8,544,666.13 € prej kategorisë "mallra dhe shërbime", duhet me i bartur në kategorinë "investime kapitale", gjë që e kemi bërë dhe e kemi sjellë sot këtë propozimvendim. Ky nuk mund të jetë vendim i ri, sepse ka shkuar njëherë dhe është votuar.

Po ashtu, edhe qarkoren nuk e kemi pranuar, 4 vite më herët e kemi pranuar para 10 korrikut, iu kemi dërguar e-mail, nuk na është kthyer përgjigje.

**Mirsad Vitia** pyeti se çka ndodh nëse nuk miratohet.

**Valbona Makolli - Ahmeti** u përgjigj se asgjë nuk ndodh, ashtu siç i kanë bllokuar tjerat i bllokojnë edhe këto mjete. Unë iu kam dërguar e-mail si me vepruar më tutje, asnjë komune nuk i është aprovuar bartja dhe arsyen nuk e di pse.

**Gëzim Sveçla** pyeti për çështjen e subvencioneve që i ka ndarë Kuvendi i Komunës për ndërmarrjet "Pastrimi" dhe "Sport Marketing".

**Valbona Makolli - Ahmeti** theksoi se për ndërmarrjen "Pastrimi" kryetari i ka marrë prej këtij viti, d.m.th. vitit 2022, fjala është vetëm për bartje të 2021-shit.

**Gëzim Sveçla** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për aneks-Planin e veprimit për personat ma aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës".

Faqe1nga9

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket këtij propozimi i kanë dorëzuar edhe disa rekomandime ose komente të KKPAK-së dhe Planin e veprimit që ka qenë paraprak, që është votuar 2021-2023.

Po ashtu, propozoi që zyra e Kuvendit ta ftojë një përfaqësues nga "Hendikos" i Prishtinës me arsyetuar këtë aneksin e Planit të veprimit.

**Gëzim Sveçla** tha se meqë jemi te rendi i ditës, desha të pyes se dokumentacionin që ua kam dërguar në seancë për pllakën përkujtimore për dëshmorët e Prishtinës të lagjes "Kodra e Trimave", a keni vepruar diçka në atë drejtim.

**Kryesuesi** dhe sqarime, duke thënë se asgjë nuk është vepruar, ka qenë e ka shikuar. Për atë lokacion që kemi biseduar, e kam parë, është një pjesë e hekurudhës, nëse atyre nuk iu pengon unë jam dakord për atë vend. Fjala është për dëshmorin Ismet Krasniqi, që ka qenë një pllakë aty e vendosur dhe pronari i shtëpisë ka kërkuar me zhvendos, dhe tani me vendosur diku afër atij lokacionit. Nuk kemi gjetur tjetër, përveç aty ku shitet gëlqerja, aty afër hekurudhës me vendosur.

**Leutrim Retkoceri** tha se një pyetje e kam pasur në raport me këtë kërkesë. Çka është e paraparë aty dhe si lokacion aty ku është veç propozimi nuk e di a i bëjmë ndër, për shkak se është kolektori që kalon aty afër, aty as nuk munden me kaluar njerëzit. Është një vend tjetër i mirë, nëse janë të pajtimit familja, te shkolla "Model", ku është një mur, aty me gjetur njëfarë modeli pak më të përshtatshëm. Po ashtu, tha se është i gatshëm, që bashkë me Gëzimin dhe kush dëshiron tjetër, me shkuar me shkuar vendin, nëse e kryen DSHP -ja, me shkuar me biseduar a e kanë ndonjë kompani që mundet me kryer.

**Gëzim Sverçla** tha se nuk është problem me shkuar, por me këtë çështje duhet të merremi në mënyrë institucionale, prej ekzekutivit ose prej kabinetit të kryetarit me marrë përgjegjësi dikush dhe me telefonuar familjen, me vazhduar punën në atë lokacion, në mënyrë që me gjetur zgjidhje më të mirë dhe me e ndërtuar.

**Kryesuesi** theksoi se ideja ka qenë aty njëherë, nëse ka ide tjetër më të mira nuk ka problem, dalim në terren e shikojmë. Ne duhet të dalim me një konkluzion të kësaj, a po pajtoheni GSHP, dhe unë, e ftojmë edhe familjen që me qenë edhe ata të pajtimit, që nesër mos me thënë po ia ndërrojmë vendin pa pëlgimin e tyre.

**Nora Kelmendi** u shpreh se asamblistët nuk dalin me shkuar lokacione, është drejtori dhe kabineti, janë njerëzit e thirrur për këtë punë, ju mundeni vetëm me iu ndihmuar.

**Bahri Gashi** theksoi se kërkesë e familjes është te vendi specifik ku është vrarë, te hekurudha, mundemi me lëvizë 10m më poshtë ose më lart, andaj le ta marrim për obligim personat kompetentë nga Komuna, le të dalin ta caktojnë lokacionin e jo asamblistët.

**Kryesuesi** tha se po vendosim pasi është kompetencë e Drejtorisë së Planifikimit me biseduare me drejtoreshë Mimozën, ndërsa Leutrimi merret me pjesën tjetër.

**Jeta Rafuna** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës edhe "Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektrregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në komunën e Prishtinës".

**Nora Kelmendi** pyeti se a ka bazë ligjore.

**Kryesuesi** tha se kjo rregullohet, sepse ka për të dalë në diskutim publik.

**Gëzim Sveçla** theksoi se edhe në diskutim publik nuk shkon, nuk mundemi me aprovuar këtë sepse ligji është në përfundim, këto specifika që janë këtu ka me na u deshtë me i përsëritur. Këto specifikat 50 voltë, 25 km në orë, është duke i bërë niveli qendror, se nuk ka ligj për këtë, se është diçka e re, dhe kjo rregullore që do ta bëjmë ne duhet me u mbështetur në atë ligj. Ne mund ta qesim në diskutim publik me votuar në asamble me shkuar, por MAPL-ja do e kthejë, sepse nuk e kemi në përputhje me ligjin.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se ideja është kjo faza për fillimin e procedurave, këtu siç po shihet është duke u marrë kjo çështja e trotineteve, është çështje urgjente, Kuvendi mundet me votuar fillimin e procedurave për dëgjim publikë. Mendoj se është me kohë, duhet proceduralisht me qituri në diskutim publike. Është e vërtetë që rregullorja duhet mbështetur në ligj, por derisa të dalë ligji mund të merren kërkuesat, procedurat mund të zhvillohen deri në një moment, i klasifikon dëgjimet, kërkuesat dhe telashet që i kanë njerëzit me atë bazë ligjore.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se pa u hartuar ligji nga nivelit qendror, çka do që veprojmë ne ka me dështuar, ka me na u kthyen njëjtë, nuk ke nevojë as në diskutim publik me e qituri në këtë formë si është.

**Mirsad Vitia** pyeti se kur pritet me u bërë kjo nga niveli qendror.

**Gëzim Sveçla** tha se komisioni është duke punuar dhe pritet me dal në Kuvend.

**Bahri Gashi** u shpreh se nuk e di pse kjo rregullore del në diskutim publik kur nuk ka ligj, në çka ka me u bazuar kjo?! Kishte qenë mirë me u hartuar ligji, pastaj me e qituri në diskutim publik rregulloren. Kemi rregullore edhe më emergjente sesa për 150 skuterë në Prishtinë, nuk është urgjente kjo me dalë paushall në diskutim publik.

**Gëzim Sveçla** theksoi se nuk është koha për këtë rregullore pa miratimin e ligjit, i cili i parashesh çështjet që kanë të bëjnë këtë temë që po trajtohet.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se për të kaluar ky propozim duhet proceduar derisa të sillet rregullorja. Ne jemi me kohë, duhet filluar procedurat e dëgjimit publik për këtë çështje prej kërkuesave që duhet adresuar. Pajtohem plotësisht me mendimin se së pari duhet shikuar ligjet ekzistuese se ku me u bazuar, ka mangësi, por në momentin që miratohet ligji me u harmonizuar në plotësim me të, por me ndaluar ekzekutivin dhe Komunën për të mos e iniciuar një procedurë të tillë, mendoj që është gabim. Ne duhet t'i japim një kaheje kërkuesës që është prej qytetarëve, si ata që vozisin që janë të rrezikuar, si ata që ecin këmbë.

**Gëzim Sveçla** tha se ne nuk kemi kompetenca, lexoje, dënimë 150 €, në çka e mbështet dënimin?!

**Nora Kelmendi** kërkoi që brenda mundësive, të na jepet opinion nga Zyra ligjore.

**Arben Kçira** theksoi se kjo nuk është rregullore, është projekt, në Kuvend nuk ka me u votuar, vetëm duhet marrë autorizimin për konsultime publike, jo me miratuar rregullore. Në aspektin procedural nuk ka pengesa. Udhëzimi administrativ i MAPL-së u jep të drejtë komunave për konsultime publike.

**Nora Kelmendi** pyeti se çka do të votohet të hënën në Kuvendin e Komunës.

**Arben Kçira** dha sqarime, duke thënë se do të votohet inicimi i kryetarit të Komunës për një rregullore në të ardhmen.

**Bahri Gashi** u shpreh se kjo duhet të kthehet, sepse nuk ka currfarë baze ligjore dhe Udhëzimi administrativ nuk të jep të drejtën me dënuar qytetarin 150 euro.

**Osman Bllaca** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal".

**Arbër Sadiki** dha sqarime lidhur me "Propozimvendimin për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal".

**Gëzim Sveçla** kërkoi që të dërgohet materiali për pikat shtesë.

Më propozimet e dhëna, kryesuesi e hodhi në votim këtë

#### R E N D TË D I T Ë S:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti finançiar buxhetor i kryeqytetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 1prill - 30 qershori 2022 (TM2);
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Valbona ( Shaip) Mërkojës, Naser ( Shaip) Mërkojës, Fatmir ( Shaip) Mërkojës dhe Ragip ( Shefki) Selimit;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Jeton (Ramiz) Hysenit, Faton (Ramiz) Hysenit dhe Driton (Ramiz) Hysenit;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxhës;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhevdet (Ahmet) Rafunës dhe Nuhi (Ahmet) Rafunës;
7. Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së;
8. Informatë lidhur me reportin vjetor të komisionit të aksionarëve të kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, Prishtinë;
9. Informatë lidhur me reportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtina;
10. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022;
11. Propozimvendimi për aneks-Planin e veprimit për personat ma aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës;

12. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektrregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në komunën e Prishtinës;
13. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal;
14. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetet për Polikë e Financa.

#### Pika e dytë

Raporti finansiar buxhetor i kryeqytetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 1prill - 30 qershor 2022(TM2).

**Valbona Ahmeti-Makolli** dha sqarime, duke thënë se në bazë të ligjit e ka dërguar bartjen tash e dy muaj, por Ministria e Financave nuk ka kthyer përgjigje. Kjo është në bazë të ligjit, në bazë të nenit, dhe e ka bllokuar krejt qytetin. Në investime kapitale nuk ka lëvizur asgjë, kështu që jemi një bllokim total sa u përket investimeve kapitale.

**Gëzim Sveçla** tha se vërejtjet tona do t'i japim në seancë. Ai parashroi pyetjen se a është ky raport i kryetarit për gjendjen ekonomike në Komunë dhe planin e investimeve, apo është raport i shpenzimeve të Komunës në përgjithësi.

**Valbona Ahmeti-Makolli** u shpreh se së bashku me kryetarin e kemi analizuar dhe e kemi bërë këtë raport.

**Vllaznim Manaj** u shpreh se ky nuk është raport i kryetarit. Kryetari është duke e përgatitur reportin për 6 mujorin e parë dhe në seancën e radhës ka me raportuar, se janë duke u mbledhur raportet prej drejtorive.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se ky raport a ka me kaluar në Ministri, se Ministria është duke i bërë gabimet më të mëdha, nuk e ka bërë rishikimin e buxhetit, ta ka bllokuar OPSH-në dhe deri tani nuk ka asnjë përgjigje.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se kryetari ka mundësi të mjaftueshme për të ndikuar te kryministri për këto çështje, duhet lobuar për të kryer punë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti finansiar buxhetor i kryeqytetit të Republikës së Kosovës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2022 (TM2) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Valbona (Shaip) Mérkojës, Naser (Shaip) Mérkojës, Fatmir (Shaip) Mérkojës dhe Ragip (Shefki) Selimit.**

**Pika e katërt**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Jeton (Ramiz) Hysenit, Faton (Ramiz) Hysenit dhe Driton (Ramiz) Hysenit.**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxhës.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhevdet (Ahmet) Rafunës dhe Nuhi (Ahmet) Rafunës.**

**Doruntinë Maloku**, sa u përket këtyre katër këmbimeve të pronave të paluajtshme të Komunës së Prishtinës, tha se ua kemi dërguar materialet dhe nuk kam asgjë për të shtuar. Nëse keni ndonjë pyetje, jemi të gatshëm unë dhe Arbri me u përgjigjur.

**Nora Kelmendi** tha se në Kuvend do të diskutojmë për këto katër propozimvendimet për këmbimin e pronave.

**Kryesuesi konstatoi se u miratuan pikat: e treta, e katërt, e pesta dhe e gjashta, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së.**

**Osman Bllaca** theksoi se pikën e shtatë duhet hequr, se është donacion dhe këtë mundet direkt kryetari me ua dhënë vetë.

**Pika e tetë**

**Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, Prishtinë.**

**Leutrim Retkoceri** tha si informatë besoj se ka me na ardhur në Kuvend, se ndërmarrjet e kanë obligim që në fund të muajit gusht me përgatitur raport. Karakteri i kësaj ndërmarrje është ndërmarrje rajonale, e cila varet edhe prej anëtarëve në bord dhe aksionarëve të komunave prej komunave regionale që janë aty. Situata nuk është e mirë në këtë ndërmarrje, auditorët kanë gjetur shkelje, kështu që në Kuvend kanë me raportuar aksionarët.

Njëherësh ceku se në momentin që është marrë vendim për shkarkimin e kryeshefit, atë ditë ka qenë një konkurs për punësimin e 40 vetave dhe brenda ditës është mbajtur intervista me shkrim dhe gojë vetëm me i punësuar.

Informatë tjetër është se aksionarët vijnë me rekomandime. Një prej rekomandimeve e që është edhe në vizionin e kryetarit të Komunës dhe të aksionarëve, është se cilët janë hapat më të mirë për të shkuar drejt ndarjes së kompanisë dhe formimit të një kompani, që do të ishte e Komunës së Prishtinës, për shkak se qëndron një pabarazi në mes përqindjes së aksioneve që i ka Komuna e Prishtinës.

Vetëm si informatë, se raport të shkruar nuk mundet, se ditën që kanë shkuar nuk dihet sa është flota e kamionëve, sa është numri i saktë i punëtorëve, sa është buxheti i kompanisë, sa ka fitim, sa ka humbje, as informatat bazë nuk kanë qenë. Në reportin që pritet të sillet në gusht, do të vije reporti edhe me rekomandimin tonë në Kuvend.

**Gëzim Sveçla** shfaqi dilemë se pse mos me pasur material, nuk është fjala për periudhën e këtij viti, por të paktën të vitit të kaluar, që me pasur një bazë dhe e fillojmë diskutimin.

**Leutrim Retkoceri** tha se reporti i auditorit është një raport i vitit të kaluar.

**Gëzim Sveçla** tha besoj që keni me na dërguar diçka në e-mail. Ne po presim çka ka me qenë ai report dhe rekomandimet dhe vërejtjet eventuale i parashtrojmë në seancë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata lidhur me reportin vjetor të komisionit të aksionarëve të kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend.**

#### Pika e nëntë

**Informatë lidhur me Reportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë.**

**Milazim Vitija** tha se sa i përket NPL "Termokos", është në gjendje më të mirë financiare dhe ekonomike. Raportet për vitet e kaluara i kemi të gjitha dhe të auditimit. Kuptohet se për këtë vite ende nuk i kemi, por ato do t'u dërgojmë me e-mail. Në ndërmarrje e kemi emëruar një bord, aty e kemi emëruar komisionin e auditorit dhe e kemi shpallur konkursin për drejtor të ri. **Nora Kelmendi** u interesua se a i ka kaluar mandati drejtorit.

**Milazim Vitija** tha po, i ka kaluar mandati drejtorit dhe e kemi shpallur konkursin. Po ashtu, edhe bordi ka qenë pa mandat.

**Mirsad Vitia** tha, d.m.th. konkursi është hapur vetëm për drejtorin ekzekutiv të ndërmarrjes, e për anëtarë të bordit jo.

**Milazim Vitija** po, vetëm për drejtor është shpall konkursi, ndërsa anëtarët e bordit janë të emëruar.

**Valbona Makolli** informoi se i erdhi lajmërimi se është nënshkruar bartja, pjesa e parë.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi nga drejtoresha në propozimin për këtë aneksplanin e Hendoksit, nëse ka mundësi me shikuar implikime buxhetor, sa ka për vitin e ardhshëm, a munden me u përfshirë këto në buxhet.

**Valbona Makolli** pyeti se a është në e-mail, që të bisedojë me Adelinën, edhe nëse nuk është duhet me futur drejtëpërdrejt përmes Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Do ta bisedoj me drejtorinë prapë, sepse, me sa e di unë, tash e tutje kryetari ka dhënë urdhër mos me u dhënë asnje leje për ndërtim pa pjerrina për të hendikepuarit.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata lidhur me raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për aneks-Planin e veprimit për personat ma aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për aneks-Planin e veprimit për personat ma aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e dytëdhjetë**

**Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektrregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në komunën e Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektrregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme.

**Valbona Ahmeti-Makolli** kërkoi që në mbledhjet e Kuvendit ose të shkurtohen diskutimet, ose të ndahet mbledhja në dy pjesë, se po zgjat deri vonë e po është problem edhe me u përgjigjur në pyetje e shtruara.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:35.*

Procesmbajtësja  
Shyhare Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina



Faqe9nga9